



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 76, Datë 22.04.2020

MBI

KËRKESËN E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OST SH.A.

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË
PAJTUESHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, kreut VI, gërma C, pika 1, të Programit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr .103 datë 30.04.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2020, mbasi shqyrtoi Informacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të pajtushmërisë të OST sh.a.për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtushmërisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 103, datë 30.04.2018, ka vendosur të miratojë Programin e Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike.
- Në kreun VI, gërma C, pika 1, të këtij programi, përcaktohet si vijon: *Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i pajtushmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.*
- Me komunikimin elektronik të datës 09.04.2020, Zyrtari i Pajtushmërisë së OST sh.a., ka bërë me dije se, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, ka qenë i pamundur përfundimi i Raportit Vjetor brenda afatit të caktuar.
- Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar për shkak të COVID-19 dhe kufizimet që janë vendosur, me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, kërkesa e Zyrtarit të Pajtushmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të Raportit Vjetor deri jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, është e drejtë dhe në

harmoni me vendimmarrjet e ERE Nr. 51, datë 26.03.2020 si dhe Nr. 67, datë 08.04.2020, mbi masat e përkohëshme për trajtimin e çështjeve në kompetencë të ERE-s pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, gërma C, pika 1, të Programit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 103, datë 30.04.2018, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë Zyrtarin e Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI